www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2016 – Numri: 76

Tiranë – E premte, 6 maj 2016

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 321, datë 27.4.2016	Për miratimin e dokumentit "Standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri - Tema: Parcelat kadastrale".....	4355

VENDIM
Nr. 321, datë 27.4.2016

PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT "STANDARDET SHTETËRORE PËR SPECIFIKIMET TEKNIKE TË INFORMACIONIT GJEOHAPËSINOR NË SHQIPËRI - TEMA: PARCELAT KADASTRALE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 11, pika 2, shkronja "e", dhe 16, pika 1, të ligjit nr.72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e dokumentit "Standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri - Tema: Parcelat kadastrale", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) dhe autoritetet përgjegjëse për krijimin, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave gjeohapësinore, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

STANDARDET SHTETËRORE PËR SPECIFIKIMET TEKNIKE TË INFORMACIONIT GJEOHAPËSINOR NË SHQIPËRI - TEMA: PARCELAT KADASTRALE

1. PËRSHKRIM MBI STANDARDIN

Ky dokument përmban standardet e specifikimeve teknike të të dhënave gjeohapësinore për ndërtimin e NSDI, duke u mbështetur në Direktivën INSPIRE. Autori i këtij produkti është Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) **dhe në bashkëpunim me INSTAT, Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile, ZQRPP dhe ALUIZNI-n**. Data e publikimit të versionit Nr.1 është Tetor 2015. Emërtimi i dokumentit është: ASIG_Standard_NSDI_2015_PK_v.1 ku:

ASIG – Autoriteti përgjegjës për krijimin e standardit
Standard – Lloji i dokumentit
NSDI – Qëllimi i dokumentit
2015 – Viti i krijimit
PK – Tema për të cilën është krijuar standardi: Parcelat Kadastrale.
v.1 – Numri i versionit të standardit

2. HYRJE

2.1. SI LEXOHET DOKUMENTI

Ky material është i strukturuar në katër kapituj kryesorë:

1- **Përshkrim mbi standardet** – Në këtë pjesë jepen emërtimi dhe autori i standardeve.
2- **Hyrje** – Në këtë pjesë jepen përshkrime dhe shpjegime për të kuptuar mënyrën si organizohet i gjithë informacioni dhe si mund të kuptohet më lehtë.
3- **Tema** – Në këtë pjesë jepen specifikimet teknike për secilën temë.
4- **Anekse** – Në këtë pjesë jepen informacione shtesë shpjeguese në ndihmë të lexuesve.

Përmbajtja e Kapitullit 3 është strukturuar në 6 pjesë kryesore:

1- **Përshkrimi i temës** – Këtu flitet në mënyrë të përgjithshme për përmbajtjen e temës.
2- **Diagramat UML** – Këtu jepet përmbajtja e Katalogut të Tipologjive përkthyer sipas gjuhës UML.
3- **Katalogu i Tipologjive** – Këtu shpjegohet struktura e temës me të gjithë elementët e saj përbërës.
4- **Metadata** – Këtu jepen specifikimet teknike për metadata-t e temës përkatëse.
5- **Sistemi Koordinativ referencë** – Këtu pëcaktohet sistemi koordinativ referencë që është i miratuar sipas vendimit Nr,669 datë 7/8/2013 .
6- **Cilësia e të dhënave** – Këtu jepet një përshkrim mbi cilësinë e të dhënave të elementëve dhe matjes së tyre.

Diagramat UML ofrojnë një mënyrë të shpejtë për të parë elementët kryesorë të specifikimeve dhe marrëdhëniet mes tyre. Përkufizimi mbi llojin e objektit hapësinor, atributet dhe marrëdhëniet janë të përfshira në Katalogun e Tipologjive (Feature Catalogue). Personat të cilët kanë ekspertizë tematike por nuk janë të familjarizuar me UML-në mund të kuptojnë plotësisht përmbajtjen e modelit të të dhënave duke

u fokusuar tek Katalogu i Tipologjive. Për përdoruesit, Katalogu i Tipologjive mund të jetë veçanërisht i dobishëm për të kontrolluar nëse ai përmban të dhënat e nevojshme për aplikacionet që ata përdorin.

Në tabelat e mëposhtme jepet një shpjegim mbi përmbajtjen dhe mënyrën e organizimit të informacionit në tabelat e të dhënave në Katalogun e Tipologjive.

Tabela Nr.1, 2, me anë të një shablloni, shpjegon mënyrën e organizimit të informacionit në tabelën e tipologjive dhe të atributeve të tyre.

Tabela Nr.3, me anë të një shablloni, shpjegon mënyrën e organizimit të informacionit në tabelën e kod listës.

Tabela 1

Emri - Emërtimi i tipologjisë	
Përkufizimi:	Përkufizimi sipas direktives INSPIRE për tipologjinë.
Përshkrimi:	Shënime dhe përshkrime të tjera për tipologjinë.
Tipi i tipologjisë	**Tipi i elementit** i cili mund të jetë i këtyre llojeve: **«featureType»** - një element i cili mund të jetë real në terren apo një fenomen abstrakt **«dataType»** - një element tabelor i cili shërben vetëm si tabelë atributesh për tu lidhur me një element tjetër. Në document gjendet e shqipëruar si 'tipet e të dhënave' **«enumeration»** - listë e parapërgatitur vlerash ku elementi duhet të marrë vlerë. **«codeList»** Enumeration nënkupton "renditje vlerash", ndërsa codeList nënkupton "listë vlerash ose ndryshe kod listë". Në dokument gjenden e shqipëruara 'Numërtimet dhe kod listat' **«Imported»** - të dhëna të specifikuara në tema të tjera të direktivës INSPIRE. Në document gjendet e shipëruar si 'Të dhënat e importuara'
Gjeometria	Gjeometria e elementit sipas formatit vektor mund të gjendet në tre forma: **pikë, linjë ose poligon.** **Abstrakt** – kur elementi nuk është element real në terren por konsiderohet vetëm si fenomen.
Shumëllojshmëria:	Lloji dhe numri i vlerave që mund të marrë atributi: 0..* - mund të marrë shumë lloje vlerash ose asnjë vlerë 1..* - mund të marrë minimum 1 vlerë ose shumë vlera 0..1 - mund të mos marrë asnjë vlerë ose nëse merr vlerë, duhet të marrë vetëm 1 vlerë të vetme. 1 - duhet të marrë detyrimisht 1 vlerë
Detyrueshme	Po – nëse atributi është i detyrueshem të plotësohet Jo – nëse atributi nuk është i detyrueshëm të plotësohet
Lidhjet	Në tabelën e lidhjeve "LIDHJET" tregohen marrëdhëniet hierarkike ndërmjet elementëve të ndryshëm në këtë temë po ashtu dhe në temat e tjera. Këto marrëdhënie pasqyrojnë lidhjet që realizohen në skemat UML.

Tabela 2

ATRIBUTET
-- **Emri** -- Emërtimi i atributit. -- **Përkufizimi** -- Përkufizimi sipas direktivës INSPIRE të elementëve. -- **Përshkrimi** -- Shënime dhe përshkrime të tjera për elementin. [Detyrueshme : Detyrueshmëria nëse atributi duhet të marrë vlerë p.sh: PO]

Tabela 3

ATRIBUTET
Vlera e parë e listës së gatshme p.sh: ***Ligjor*** -- **Emri** -- Emërtimi i vlerës. -- **Përkufizimi** -- Përkufizimi sipas direktives INSPIRE të elementëve.
Vlera e dytë (etj) e listës së gatshme p.sh: ***Jo Ligjor*** -- **Emri** -- Emërtimi i vlerës. -- **Përkufizimi** -- Përkufizimi sipas direktivës INSPIRE të elementëve.

2.1.1. KARAKTERISTIKAT E <<VOIDABLE>> DHE SHUMËLLOJSHMËRIA.

Stereotipi <<*voidable*>> përdoret për të përshkruar ato përkatësi të objekteve hapësinore të cilat mund të jenë ose mund të mos jenë prezentë në grupet e të dhënave hapësinore, edhe pse ato mund të ekzistojnë në botën reale. Kjo nuk do të thotë që këtyre përkatësive duhet ti jepet një vlerë.

Për të gjitha përkatësitë e përcaktuara për objektet hapësinore duhet të paraqitet një vlerë – ose vlera përkatëse (nëse është e disponueshme në grupin e të dhënave që mirëmbahet nga ofruesi i të dhënave) ose vlera '*void*'. Një vlerë *void* nënkupton që nuk ekziston një vlerë përkatëse në grupet e të dhënave hapësinore

që mirëmbahen nga ofruesi i të dhënave ose që asnjë vlerë përkatëse nuk mund të nxirret nga vlerat ekzistuese me kosto të arsyeshme.

Arsyeja e përdorjes së vlerës void duhet të paraqitet kurdo të jetë e mundur duke përdorur një nga vlerat e listuara në kod listën VleraEArsyesSëPavlefshmërisë (VoidReasonValue).

Stereotipi <<voidable>> nuk jep informacion nëse karakteristika ekziston ose nuk ekziston në botën reale. Kjo shprehet duke përdorur shumëllojshmërinë:

Nëse një karakteristike mund të ekzistojë apo mund të mos ekzistojë në botën reale, vlera minimale do të përcaktohet si 0. Psh nëse një adresë ka apo nuk ka një numër shtëpie, shumëllojshmëria përkatëse do të jetë 0..1.

Nëse për një karakteristikë të caktuar ekziston të paktën një vlerë në botën reale, vlera minimale do të përcaktohet si 1. Psh nëse një njësi administrative ka gjithmonë të paktën një emër, shumëllojshmëria përkatëse do të jetë 1..*.

2.1.2. RENDITJET DHE KOD LISTAT (ENUMERATION AND CODELIST).

Kod listat modelohen si klasa në skemat e aplikimit por vlerat e tyre menaxhohen jashtë skemave të aplikimit.Në kod listë, 'vlera të tjera' përcakton llojin e përmbajtjes së kod listës përcaktuar specifikisht si më poshtë:

'jo' përfaqëson kod lista që përmbajnë vetëm vlera të specifikuara në këtë rregullore.

'të kufizuara'përfaqëson kod lista të përmbajnë vlera të specifikuara në këtë rregullore dhe vlera të tjera të limituara të përcaktuara nga ofruesi i të dhënave.

'të hapura' përfaqëson kod lista që përmbajnë vlera të specifikuara në këtë rregullore dhe vlera shtesë në cdo nivel, të përcaktuara nga ofruesi i të dhënave.

'po' përfaqëson kod lista që përmbajnë vlera të përcaktuara nga ofruesi i të dhënave.

Vlerat shtesë të përcaktuara nga ofruesit e të dhënave nuk duhet të zëvëndësojnë apo modifikojnë vlerat ekzistuese të përcaktuara në rregullore.

Në rastin kur ofruesit e të dhënave do të përdorin kod lista me vlera ***jo*** të përmbajtura në rregullore, ofruesit janë të detyruar ti bëjnë këto vlera bashkë me përkufizimet e tyre, të disponueshme në një regjistër. Kjo do të mundësojë që dhe përdoruesit e tjerë ti kuptojnë këto vlera dhe të kenë mundësi t'i përdorin.

2.1.3. PARAQITJA E ASPEKTIT KOHOR.

Skemat e aplikimit përdorin atributin "FillimiIJetëgjatësisë" dhe "MbarimiIJetëgjatësisë" për të regjistruar jetëgjatësinë e një objekti hapësinor.

Atributi "FillimiIJetëgjatësisë" specifikon datën kur versioni i objektit hapësinor është futur apo ndryshuar në grupin e të dhënave hapësinore (në sistem). Atributi "MbarimiIJetëgjatësisë" specifikon datën kur versioni i objektit hapësinor është zëvëndësuar apo tërhequr nga grupi i të dhënave hapësinore (në sistem). Këto vlera kohore nuk kanë të bëjnë me karakteristikat kohore të objektit në botën reale.

Ndryshimet që bëhen në atributin "MbarimiJetëgjatësisë" nuk shkaktojnë ndryshime në atributin "FillimiJetëgjatësisë".

❖ Shënim i rëndësishëm:
Disa terma në katalogun e tipologjive si p.sh: tipi i tipologjisë, etj, nuk janë përkthyer qëllimisht në gjuhën Shqipe. Qëllimi parësor është që të mos humbasë kuptimi gjatë përkthimit dhe së dyti të përdoret një gjuhë unike sipas termave të Direktivës INSPIRE.

2.2. DETYRIMET LIGJORE

Në bazë të ligjit Nr 72/2012, neni 16, "Për organizimin dhe funksionimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë", ASIG është përgjegjës për krijimin e standardeve për secilën nga temat e përcaktuara në ligj (neni 11), në përputhje me standardet europiane (direktiva INSPIRE).

Standardet teknike të të dhënave gjeohapësinore për krijimin e NSDI në Shqipëri, janë përshtatur nga specifikimet teknike të temave përkatëse në direktivën INSPIRE. Për implementimin e direktivës, kërkohet që të gjithë aktorët të implementojnë disa standarde të përbashkëta, të cilat mundësojnë ndërveprimin e shërbimeve dhe harmonizimin e të dhënave.

Standardet (Rregullat e Implementimit (IR)) duhet të krijohen për fushat e mëposhtme:

- **Metadata** – në këtë fushë direktiva përcakton standardet sesi duhet të jenë metadata-t. Ky standard është unik dhe i aplikueshëm për të gjithë institucionet ose palët e treta (siç është e përcaktuar në fushën e veprimit të kësaj direktive), të cilët do implementojnë këtë direktive.

- **Specifikimi i të dhënave** – standardet e kësaj kategorie përfshijnë të gjitha atributet e objekteve të ndryshme të cilat do të publikohen. INSPIRE ka përcaktuar disa atribute si bazë e cila do të shërbejë për publikimin e të dhënave të ndryshme. Vendet e ndryshme, në varësi të ligjeve ose nevojave të brendshme mund të shtojnë atribute të tjera, për ti bërë sa më të përdorshme të dhënat. Të gjitha të dhënat që do të shtohen duhet të jenë të dokumentuara dhe të aprovuara nga autoritetet përgjegjëse lokale.

2.3. FUSHA E VEPRIMIT

Të gjithë autoritetet publike, kompani private apo individët, të cilët mbajnë ose përpunojnë të dhëna gjeohapësinore për llogari të Institucioneve Publike, janë të detyruar ti nënshtrohen kësaj rregulloreje.

Bazuar në modelet e proceseve të biznesit, sistemi i propozuar nga direktiva INSPIRE ka proceset dhe ciklin jetësor si më poshtë:



Figura 1

Planifikimi – Është procesi gjatë të cilit krijohen strukturat e të dhënave të nevojshme për të publikuar informacionin në portal. Rezultatet e këtij procesi janë modelet e ndryshme të të dhënave.

Vlerësimi – Është procesi gjatë të cilit të dhënat ekzistuese testohen kundrejt modelit. Rezultati i këtij procesi do jetë çertifikimi i të dhënave ose nevoja për të modifikuar të dhënat për tu përshtatur me modelet e përcaktuara gjatë procesit të vlerësimit.

Procesimi – Është procesi gjatë të cilit mblidhen dhe manipulohen atributet e të dhënave për të prodhuar informacion kuptimplotë. Manipulimi i tyre bëhet kundrejt modeleve të përcaktuar gjatë planifikimit. Rezultatet e këtij procesi, janë bashkësi të dhënash të cilat janë gati për tu publikuar.

Shpërndarja – Është procesi gjatë të cilit të dhënat vihen në dispozicion për përdoruesit (Qytëtarët, Autoritetet publike, Organizatat ose Palët e treta). Përdoruesi mund të shkarkojë, përdorë, analizojë ose të citojë ato. Publikimi i të dhënave bazohet në modelet e ndryshme të përdorimit.

Zbulimi – Është procesi i vazhdueshëm mbi të dhënat e publikuara, gjatë të cilit zbulohen të dhëna të reja ose të dhëna jo cilësore.

Analiza – Është procesi i analizimit të të dhënave të evidentuara në fazën e zbulimit. Gjatë këtij procesi merret vendimi cfarë do bëhet më të dhënat që janë evidentuar.

Përditësimi – Është procesi kur propozohet shtimi, modifikimi ose fshirja e të dhënave. Ky proces rregjistrohet nga procesi i analizimit të të dhënave ekzistuese dhe të publikuara.

Arkivimi – Është procesi gjatë të cilit, bashkësitë e të dhënave që nuk nevojiten të aksesohen, arkivohen duke u bazuar në standarde lokale dhe në legjislacionin në fuqi të vendeve ku implementohet. Rezultati i këtij procesi janë të dhënat të cilat bëhen të pa aksesueshme për publikun, me akses vetëm nga autoritetet specifike. Këto të dhëna vazhdojnë të ruhen për arsye të përputhshmërisë me kuadrin ligjor në fuqi ose standardet specifike.

Shkatërrimi – Është procesi gjatë të cilit, të dhënat bëhen të pa rikuperueshme. Ky proces bazohet në standarde lokale ose legjislacione në fuqi.

3. TEMA

3.1. PARCELAT KADASTRALE

3.1.1. PËRSHKRIMI I TEMËS

Tema 'Parcelat kadastrale' sipas direktivës INSPIRE është përfshirë në Aneksin I, ndërsa sipas Ligjit Nr 72/2012 është prioritet, që nënkupton se konsiderohen si të dhëna referencë, d.m.th. të dhëna që përbëjnë kornizën hapësinore për lidhjen dhe/ose orientimin tek informacione të tjera, që i përkasin fushës specifike tematike si mjedisi, dheu, përdorimi i tokës dhe shumë të tjerë.

Procesi

Specifikimet teknike e të dhënave gjeohapësinore për parcelat kadastrale janë përgatitur duke ndjekur parimin e pjesëmarrjes në procesin e ndërtimit të konsensusit. Palët e interesuara, sipas grupit të punës, patën mundësinë për të paraqitur kërkesat e përdoruesve dhe materiale referencash, propozimet e ekspertëve për krijimin e specifikimeve dhe të merrnin pjesë në rishikimin e këtyre specifikimeve të të dhënave. Grupi Tematik i Punës përgjegjës për zhvillimin e specifikimit përbëhej nga ekspertë, që vinin nga institucionet përgjegjëse.

Themeli i zhvillimit të specifikimit ishte përcaktimi i Direktivës për parcelat kadastrale: "zonat e përcaktuara nga parcelat kadastrale ose të barasvlershme me to". Në përputhje me sistemin ligjor çdo Shtet Anëtar mban një regjistër përkatës nën përgjegjësinë e qeverisë. Regjistra të tillë quhen regjistri i pasurisë së paluajtshme, ku njësia bazë është parcela kadastrale. Parcelat kadastrale zakonisht formojnë një ndarje të vazhdueshme të territorit kombëtar me përjashtim të rasteve kur disa toka nën zotërimin e qeverisë nuk i nënshtrohen regjistrimit.

Përkufizimi i përgjithshëm i parcelave kadastrale është plotësuar nga Grupi Tematik i Punës për t'u përshtatur më mirë me kërkesat e përdoruesit sipas mënyrës vijuese: parcelat kadastrale, aty ku është e mundur, duhet të jenë zona të vetme të sipërfaqes së tokës (tokë dhe/ose ujë) sipas të drejtave të pasurive të paluajtshme homogjene dhe pronësisë unike, ku të drejtat e pasurive të paluajtshme përcaktohen nga ligjet kombëtare.

Ky dokument nuk synon të harmonizojë parimet e pronësisë dhe të drejtat që lidhen me parcelat, por përqendrohet në aspektet gjeometrike siç paraqiten në sistemin kombëtar.

Modeli i të dhënave për parcelat kadastrale është përgatitur në një mënyrë, që mbështet përputhshmërinë me standardin ndërkombëtar të ardhshëm mbi Modelin e Sferës së Administrimit të Tokës. Modeli i Sferës së Administrimit të Tokës (MSAT) siguron një kontekst më të gjerë për Parcelat Kadastrale sepse MSAT përfshin informacione shtesë mbi të drejtat (të detyrueshme për legjislacionin kombëtar) dhe pronarët.

Elementi thelbësor i modelit të parcelave kadastrale të këtij standardi është vetë parcela kadastrale. Ajo përshkruhet nga disa elementë të detyrueshëm si gjeometria, identifikuesi unik, referenca kadastrale dhe etiketimi i parcelave, që mbështet identifikimin e tyre në hartat e shtypura.

Si konkluzion, vlera kryesore e modelit të *Parcelave Kadastrale* është struktura e saj e thjeshtë, por fleksibël që iu mundëson ofruesve të të dhënave publikimin e të dhënave ekzistuese në mënyrën më të volitshme të mundshme.

Për temën 'Parcelat Kadastrale', termat vijues janë përkufizuar në mënyrë specifike si mëposhtë:

- Boshllëku kadastral

Zonë që nuk është menduar të mbulohet me parcela kadastrale për shkak të rregullave kombëtare.

*Shënim: Nuk duhet ngatërruar me zona ende të pastudiuara dhe të paregjistruara.

SHEMBULL: në shumë vende, deti etj.

- Mbivendosja kadastrale

Zonë që mund të mbulohet me disa parcela kadastrale për shkak të rregullave kombëtare.

SHEMBULL: Në Mbretërinë e Bashkuar, parcelat e mbivendosura mund të ndodhin aty ku janë regjistruar të drejta të ndryshme në të njëjtën hapësirë, d.m.th. një e drejtë absolute dhe një pronë e dhënë me qira.

- Boshllëku topologjik

Zonë që është e mbuluar me parcela kadastrale në terren, por jo në dataset-in hapësinor.

SHEMBULL: Boshllëqet topologjike mund të ndodhin kur kryhet grumbullimi i parcelave kadastrale nga disa sipërfaqe kadastrale ose pas shndërrimit të formatit.

- Mbivendosja topologjike

Zonë që është e mbuluar vetëm me një parcelë kadastrale në terren, por nga disa parcela në setin e të dhënave hapësinore.

SHEMBULL: Mbivendosjet topologjike mund të ndodhin kur kryhet grumbullimi i parcelave kadastrale nga disa sipërfaqe kadastrale ose pas shndërrimit të formatit.

3.1.2. DIAGRAMAT UML

3.1.2.1. SKEMA E APLIKIMIT TE 'PARCELAT KADASTRALE'



Figura 2 - Lidhja e Skemës së aplikimit së 'Parcelat Kadastrale' me të tjerat.

3.1.2.2. NUMËRTIMET DHE KOD LISTAT

Figura 2 - Enumerations & codelists

3.1.2.3. TIPOLOGJIA E TEMËS 'PARCELAT KADASTRALE'



Figura 3 - Feature type – Tipologjia e temës 'Parcelat Kadastrale'

3.1.2.4. TË DHËNAT E IMPORTUARA



Figura 4 - Lidhja e Parcelave Kadastrale me Adresat dhe Njesitë Administrative.



Figura 5 – Të dhënat e importuara nga tema: Emërtimet Gjeografike

3.1.2.5. STRUKTURA E TEMËS 'PARCELAT KADASTRALE'



Figura 6 - Struktura e temës 'Parcelat Kadastrale'

3.1.3. KATALOGU I TIPOLOGJISË – FEATURE CATALOGUE

3.1.3.1. PËRSHKRIM

Një ZK është njësia bazë për administrimin e regjistrit të pasurive të paluajtshme dhe përfaqëson një pjesë të sipërfaqes së tokës e përcaktuar gjeografikisht (pa shkëputje territoriale), zakonisht një fshat, një qytet, një lagje në qytetet e mëdha , ose një sipërfaqe toke që përfshin 4000-5000 pasuri. Cdo ZK ka një numër unik të përbërë nga 4 shifra (p.sh. ZK 1111) i cili vendoset në bazë të renditjes së emrave të ZK sipas rendit alfabetik.

Cdo pasuri brenda një ZK merr një numër unik (të vecantë) i cili nuk përsëritet brenda kësaj ZK.

- ***Në ZK rurale:*** vendosja e numrit të pasurive në një ZK bëhet duke filluar nga skaji veriperëndimor i saj dhe vazhdon nga perëndimi në lindje dhe në rendin e dytë nga lindja në perëndim e kështu me rradhë. Numërohen në vazhdimësi të gjitha poligonet pavarësisht nga lloji i tyre, me përjashtim të pyjeve, kullotave, rrugëve, kanaleve, përrenjve, lumit, etj, që mund të shtrihen përbri parcelave ose gjatë gjithë ZK, të cilat numërtohen të fundit.Në pasuritë e paluajtshme të llojit tokë bujqësore (arë, pemtore, vreshtë, ullishte) numri i pasurisë përbëhet nga dy njësi të ndara me fraksion (shembull: 123/7). Pjesa e parë e numrit tregon numrin e parcelës kadastrale të pa ndarë (123 "parcela mëmë") sipas hartave kadastrale të krijuara para vitit 1991, dhe pjesa e dytë, pas fraksionit, tregon numrin e nën-ndarjes (7) së "parcelës mëmë". Nën-ndarjet fillojnë me numrin 1. Kur pasuria "mëmë" ka numër me fraksion, pasuritë e krijuara do të kenë numër me dy fraksione. Ka edhe pasuri që nuk janë ndarë nga privatizimi të cilat mbajnë ish numrin kadastral.

- ***Në ZK urbane:*** ZK të qytetit ndahen në blloqe të kufizuara nga rrugët. Madhësia e bllokut varet nga numri i pasurive dhe sipërfaqja. Rekomandohet që blloku të ketë jo më shumë se 400 parcela dhe sipërfaqe jo më shumë se 7ha. Numërtimi i blloqeve brenda një ZK bëhet nga e majta në të djathtë, duke filluar me numrin 1. Numrat e blloqeve nga njëri tek tjetri janë në vazhdimësi. Numri i bllokut është pjesë përbërëse e pasurisë.

- Numërtimi i parcelave (pasurive) brenda cdo blloku bëhet me të njejtin kriter si më sipër. Numri i pasurisë formohet me numrin e bllokut / numrin e parcelës. (Shembuj: numri i pasurisë së parë të bllokut të parë të ZK është 1/1 dhe numri i pasurisë së tretë të bllokut të pestë të ZK është 5/3.)

- Parcelat që priten prej rrugëve, hekurudhave etj, marrin numra të vecantë sipas pjesëve që janë ndarë.

- Në rast kur parcela ndahet prej një vije uji ose prej një rruge këmbësorësh, pjesët lidhen me shenjën e posedimit (shih shenjat konvencionale) dhe nuk marrin numra të vecantë. Po kështu, ndërtesat dhe pjesët e parcelave që i përkasin një pronari, lidhen me shenjën e posedimit dhe nuk marrin numra të vecantë.

- Rrugët kryesore të një ZK, si rregull, marrin vetëm një numër derisa të mos priten brenda asaj ZK prej rrugëve të tjera kryesore, lumenjëve ose përrenjëve. Vazhdimi i të njëjtës rrugë në ZK kufitare merr numër tjetër.

- Lumenjtë e përrenjtë të cilët kufizojnë dy zona kadastrale, sipas aksit të një lumi, marrin në cdo zonë numër të vecantë.

Lulishtja publike në të gjitha rrugicat dhe vendet e shëtitjeve merr një numër të vetëm. Ndërtesat që ndodhen në lulishte marrin numër të vecantë vetëm për sipërfaqen që ato zënë.

3.1.3.2. KUFIJTË KADASTRALË

-- Emri --
Kufijtë kadastralë

-- Përkufizimi --
Kufiri brenda të cilit shtrihet një parcelë kadastrale. Një kufi kadastral mund të ndahet me dy parcela kadastrale fqinje.

-- Përshkrimi --
Në kontekstin e INSPIRE, kufijtë kadastralë do të bëhen të disponueshëm nga shtetet anëtare ku informacioni i saktësisë absolute të pozicionimit regjistrohet për kufirin kadastral (saktësia e përllogaritur e atributit).

Tipi i elementit – FeatureType

Lidhje ndihmëse
OCL. SaktësiaELlogaritUoM /* Vlera e SaktësiaELlogaritur duhet të jepet në metra (m). */ inv: self.estimatedAccuracy.uom.uomSymbol='m'
OCL. EVlefshmeDeri /* Nëse vendoset vlera EVlefshmeDeri, ajo duhet të jetë më e vonë se EVlefshmeNga */ inv: self.validTo .isEqual(self.validFrom) or self.validTo .isAfter(self.validFrom)
OCL. MbarimiIJetëgjatësisë /* Nëse vendoset, vlera MbarimiIJetëgjatësisë duhet të jetë më e vonë se FillimiIJetëgjatësisë */ inv: self.endLifespanVersion .isAfter(self.beginLifespanVersion)

Atributet
EvlefshmeDeri : Datë-Orë Shumëllojshmëria: [0..1] **-- Emri --** E vlefshme deri.

Atributet

-- **Përkufizimi** --
Data dhe koha në të cilën kufiri kadastral përfundon/ose do të përfundojë së përdoruri ligjërisht.

-- **Shënim** --
Kjo është data dhe ora e referencës kadastrale kombëtare e cila nuk mund të përdoret më në veprimet ligjore.

[Detyrueshme : JO]

EvlefshmeNga : Datë-Orë
Shumëllojshmëria: [0..1]

-- **Emri** --
E vlefshme nga.

-- **Përkufizimi** --
Data dhe koha zyrtare e kufirit kadastral që ishte/do të vendoset ligjërisht.

-- **Shënim** --
Kjo është data dhe koha kur mund të përdoret referenca kadastrale kombëtare në veprimet ligjore.

[Detyrueshme : PO]

FillimiIJetëgjatësisë : Datë

-- **Emri** --
Fillimi i jetëgjatësisë

-- **Përkufizimi** --
Data në të cilën ky Versioni i objektit hapësinor është krijuar ose ndryshuar në të dhënat hapësinore.

[Detyrueshme : PO]

Gjeometria : Linjë

-- **Emri** --
Gjeometria

-- **Përkufizimi** --
Gjeometria e kufirit të parcelës kadastrale

[Detyrueshme : PO]

InspireId : Identifikues
Shumëllojshmëria: [0..1]

-- **Emri** --
Inspire Id

-- **Përkufizimi** --
Identifikues i jashtëm i objektit hapësinor.

-- **Përshkrimi** --

Atributet

Një objekt identifikues i jashtëm është një identifikues unik i objektit të publikuar nga autoriteti përgjegjës, I cili të mund të përdoret nga aplikacionet e jashtme të referimit të objektit hapësinor. Identifikuesi është një identifikues i objektit hapësinor, jo një identifikues i fenomenit në botë.

[Detyrueshme : PO]

MbarimiIJetëgjatësisë : Datë - Orë
Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Emri --
Mbarimi i jetëgjatësisë

-- Përkufizimi --
Data në të cilën ky Versioni i objektit hapësinor është përfunduar.

[Detyrueshme : JO]

SaktësiaELlogaritur : Gjatësi
Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Emri --
Saktësia llogaritur

-- Përkufizimi --
Saktësia absolute e përllogaritur e pozicionimit të kufirit kadastral në sistemin e përdorur të referencave të koordinatave të INSPIRE. Saktësia absolute e pozicionimit është vlera mesatare e pozicionimit të pasigurive për një grup pozicionesh, ku pasiguria pozicionale është largësia mes një pozicioni të matur dhe asaj çfarë konsiderohet si pozicioni i vërtetë përkatës.

-- Përshkrimi --
Kjo vlerë mesatare mund të vijë nga matjet cilësore në një popullsi homogjene të kufijve kadastralë ose nga një përllogaritje e bazuar në njohuritë e proceseve të prodhimit dhe saktësisë së tyre.

[Detyrueshme : PO]

LIDHJET

Lidhjet (drejtimi:Origjina -> Objektivi)

-- Përkufizim --
The cadastral parcel(s) outlined Nga this cadastral boundary. A cadastral boundary may outline one or two cadastral parcels.

Origjina: (Class) KufijtëKadastralë «featureType»

Objektivi: «voidable» Parcela (Class) ParcelatKandastrale «featureType»
Shumëllojshmëria: [1..2]

-- Përkufizim --
Parcela kadastrale konturohet nga ky kufi kadastral. Një kufi kadastral mund të konturojë një ose dy parcela kadastrale.

3.1.3.3. VLERA E NIVELIT TË ZONËS KADASTRALE

-- Emri --
Vlera e nivelit të zonës kadastrale.

-- Përkufizimi --
Nivelet e hierarkisë të zonave kadastrale.

-- Përshkrimi --
Nivelet më të larta të hierarkisë së temës kufijtë e njësive administrative (shteti) nuk përsëriten në këtë listë kodesh.

Tipi i elementit – Enumeration & CodeList

Atributet
Rendi1 : **-- Emri --** Rendi i parë **-- Përkufizimi --** Niveli më i lartë (sipërfaqet më të mëdha) në hierarkinë e zonave kadastrale, të barabarta ose të barasvlershme me zonat e rregjistrimit. Regjistrimit eshte territori qe perfshin nga disa zona kadastrale qe ndodhen ne administrim te nje ZVRPP-je.
Rendi2 : **-- Emri --** Rendi i dytë **-- Përkufizimi --** Niveli i dytë në hierarkinë e zonave kadastrale, të barabarta ose të barasvlershme me zonen kadastrale.
Rendi3 : **-- Emri --** Rendi i tretë **-- Përkufizimi --** Niveli i tretë në hierarkinë e zonave kadastrale, të barabarta ose të barasvlershme me bllokun kadastral.
Rendi4 : **-- Emri --** Rendi i katërt **-- Përkufizimi --** Niveli i katërt në hierarkinë e zonave kadastrale, të barabarta ose të barasvlershme me parcelen kadastrale.

3.1.3.4. PARCELAT KADASTRALE

- Emri --
Parcelat kadastrale

-- Përkufizimi --
Parcela kadastrale është një sipërfaqe tokësore (tokë dhe/ose ujë) mbi të cilën ekzistojnë të drejta juridike pronësie homogjene sipas një titulli të vertetuar nga një akt bazuar në legjislacionin kombëtar.

-- Shënim --
Në kontekstin e INSPIRE, parcelat kadastrale duhet të formojnë, aq sa të jetë e mundur, një ndarje të territorit kombëtar.

Tipi i elementit – FeatureType

Lidhje ndihmëse
OCL. LlojiIGjeometrisë /* Lloji i gjeometrisë mund të jetë sipërfaqe ose shumë-sipërfaqëshe */ inv: geometry.oclIsKindOf(GM_Surface) or geometry.oclIsKindOf(GM_MultiSurface)
OCL. VleraESipërfaqesUoM /* Vlera e VleraESipërfaqes duhet të jepet në metër katror (m2). */ inv: self.areaValue.uom.uomSymbol='m2'
OCL. EVlefshmeDeri /* Nëse vendoset vlera EVlefshmeDeri, ajo duhet të jetë më e vonë se EVlefshmeNga */ inv: self.validTo .isEqual(self.validFrom) or self.validTo .isAfter(self.validFrom)
OCL. MbarimiIJetëgjatësisë /* Nëse vendoset, vlera MbarimiIJetëgjatësisë duhet të jetë më e vonë se FillimiIJetëgjatësisë */ inv: self.endLifespanVersion .isAfter(self.beginLifespanVersion)

Atributet
NumriIPasurisë : CharacterString **-- Emri --** Numri I pasurisë **-- Përkufizimi --**

Atributet

Teksti i përdorur gjerësisht për të shfaqur identifikimin e parcelës kadastrale.

-- Shënim --
Numri I pasurisë zakonisht është pjesa e fundit e referencës kadastrale.

[Detyrueshme : PO]

EvlefshmeDeri : Datë
Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Emri --
E vlefshme deri.

-- Përkufizimi --
Data dhe koha në të cilën parcela kadastrale përfundon/ose do të përfundojë së përdoruri ligjërisht.

-- Shënim --
Kjo është data dhe ora e referencës kadastrale kombëtare e cila nuk mund të përdoret më në veprimet ligjore.

[Detyrueshme : JO]

EvlefshmeNga : Datë
Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Emri --
E vlefshme nga.

-- Përkufizimi --
Data dhe koha zyrtare e parcelës kadastrale që ishte/do të vendoset ligjërisht.

-- Shënim --
Kjo është data dhe koha kur mund të përdoret referenca kadastrale kombëtare në veprimet ligjore.

[Detyrueshme : PO]

FillimiIjetëgjatësisë : Datë

-- Emri --
Fillimi i jetëgjatësisë

-- Përkufizimi --
Data në të cilën ky Versioni i objektit hapësinor është krijuar ose ndryshuar në të dhënat hapësinore.

[Detyrueshme : PO]

Gjeometria : Poligon

-- Emri --
Gjeometria

-- Përkufizimi --
Gjeometria e parcelës kadastrale

Atributet

[Detyrueshme : PO]

InspireId : Identifikues

-- Emri --
Inspire Id

-- Përkufizimi --
Identifikues i jashtëm i objektit hapësinor.

-- Përshkrimi --
Një objekt identifikues i jashtëm është një identifikues unik i objektit të publikuar nga autoriteti përgjegjës, i cili mund të përdoret nga aplikacionet e jashtme të referimit të objektit hapësinor. Identifikuesi është një identifikues i objektit hapësinor, jo një identifikues i fenomenit në botë.

[Detyrueshme : PO]

MbarimiJetëgjatësisë : Datë
Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Emri --
Mbarimi i jetëgjatësisë

-- Përkufizimi --
Data në të cilën ky Versioni i objektit hapësinor është përfunduar.

[Detyrueshme : JO]

PikaReferenë : Pikë
Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Emri --
Pika referencë

-- Përkufizimi --
Një pikë në parcelën kadastrale (centroidi).

-- Shënim--
P.sh. Qendra e gjeometrisë së parcelës

[Detyrueshme : PO]

ReferencaKombëtareKadastrale : CharacterString

-- Emri --
Referenca kombëtare kadastrale

-- Përkufizimi --
Identifikues tematik në nivel kombëtar, përgjithësisht kodi i plotë kombëtar i parcelës kadastrale. Duhet të sigurojë lidhjen me regjistrin kadastral kombëtar ose të barasvlershëm me të.

-- Shënim--

Atributet

Referenca kadastrale kombëtare mund të përdoret edhe në kërkesat e mëtejshme në shërbimet kombëtare.

[Detyrueshme : PO]

VleraEsipërfaqes : Sipërfaqe
Shumëllojshmëria: [0..1]

- Emri --
Vlera e sipërfaqes

-- Përkufizimi --
Vlerë e regjistruar e zonës që përcakton sasinë e sipërfaqes së projektuar në rrafshin horizontal të parcelës kadastrale.

[Detyrueshme : PO]

LIDHJET

Lidhjet (drejtimi:Origjina -> Objektivi)

-- Përkufizim --
Parcela kadastrale i përket një njësie administrative.

Origjina: (Class) ParcelatKandastrale «featureType»

Objektivi: «voidable» NjësitëAdministrative (Class) NjësitëAdministrative «featureType»
Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Përkufizim --
Njësia administrative e nivelit më të ulët përmban këtë parcelë kadastrale.

Lidhjet (drejtimi:Origjina -> Objektivi)

-- Përkufizim --
Zona kadastrale përmban këtë parcelë kadastrale.

Origjina: (Class) ParcelatKandastrale «featureType»

Objektivi: «voidable» ZonaKadastrale (Class) ZonaKadastrale «featureType»
Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Përkufizim --
Zona kadastrale e njësisë më të ulët përmban këtë parcelë kadastrale.

Lidhjet (drejtimi:Origjina -> Objektivi)

-- Përkufizim --
Parcela kadastrale kufizohet nga ky kufi kadastral. Një kufi kadastral mund të kufizojë një ose dy kufij kadastralë.

LIDHJET	
Origjina: (Class) KufijtëKadastralë «featureType»	Objektivi: «voidable» Parcela (Class) ParcelatKandastrale «featureType» Shumëllojshmëria: [1..2] **-- Përkufizimi --** Parcela kadastrale konturohet nga ky kufi kadastral. Një kufi kadastral mund të konturojë një ose dy parcela kadastrale.
Lidhjet (drejtimi: Origjina -> Objektivi) Origjina: (Class) Adresa «featureType»	Objektivi: «voidable» Parcelë (Class) ParcelatKandastrale «featureType» Shumëllojshmëria: [0..*] **-- Përkufizim --** Parcela kadastrale që kjo adresë është e lidhur. **-- Përshkrim --** Një adresë mund të ketë lidhje me zero, një ose shumë parcela kadastrale. Gjithashtu është e mundur që shumë adresa të lidhen me një parcelë kadastrale (kjo nuk është e paraqitur në keto skema aplikimi.

3.1.3.5. ZONA KADASTRALE

-- Emri --
Zona kadastrale

-- Përkufizim –
Zona kadastrale është sipërfaqja e tokës e përcaktuar gjeografikisht (pa shkëputje territoriale), zakonisht një fshat, një qytet, një lagje në qytetet e mëdha , ose një sipërfaqe toke që përfshin nje numer te konsiderueshem parcelash kadastrale, dhe përdoret për të mbartur informacionin e metadatave dhe për të lehtësuar portretizimin e të dhënave të regjistrit të pasurive të paluajtshme.

-- Përshkrim –
Në kontekstin e INSPIRE, zonat kadastrale janë Sipërfaqe terreni (toke dhe/ose uji) të ndërmjetme që ndajnë territorin kombëtar me qellim administrimin e regjistrit te parcelave kadastrale dhe do të përdoren për të mbartur informacion të metadata-ve dhe për të lehtësuar portretizimin e të dhënave. Zonat kadastrale përgjithësisht përcaktohen kur harta kadastrale krijohet për herë të parë.

Tipi i elementit – FeatureType

Lidhje ndihmëse

OCL. HierarkiaENivelitTëZonësKadastrale

/* Një zonë kadastrale e nivelit të ulët duhet të jetë pjesë e një niveli më të lartë. */
inv: self.nationalLevel <> '1stOrder' implies self.level < self.upperLevelUnit.level

OCL. SaktësiaELlogariturUoM

/* Vlera e SaktësiaELlogaritur duhet të jepet në metra (m). */
inv: self.estimatedAccuracy.uom.uomSymbol='m'

OCL. EVlefshmeDeri

/* Nëse vendoset vlera EVlefshmeDeri, ajo duhet të jetë më e vonë se EVlefshmeNga */
inv: self.validTo .isEqual(self.validFrom) or self.validTo .isAfter(self.validFrom)

OCL. MbarimiIJetëgjatësisë

/* Nëse vendoset, vlera MbarimiIJetëgjatësisë duhet të jetë më e vonë se FillimiIJetëgjatësisë */
inv: self.endLifespanVersion .isAfter(self.beginLifespanVersion)

Atributet

EmërtesaEHartësNëShkallënOrigjinale : Integer
Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Emri --
Emërtesa e hartës në shkallën origjinale

-- Përkufizimi --
Emërtuesi në shkallë të hartës origjinale në letër (nëse ka) me të cilën korrespondon zona kadastrale.

-- Shënim--
P.sh. 2000 që nënkupton harta origjinale kadastrale ishte e shkallës 1:2000

[Detyrueshme : PO]

Emërtimi : EmërtimetGjeografike
Shumëllojshmëria: [0..*]

-- Emri --
Emërtimi

-- Përkufizimi --
Emërtimi i zonës kadastrale

-- Shënim --
Zonat kadastrale që janë gjithashtu njësi administrative ka në përgjithësi një emërtim.

Atributet

[Detyrueshme : PO]

EmriINiveli : CharacterString
Shumëllojshmëria: [1..*]

-- Emri --
Emri i nivelit

-- Përkufizimi --
Emri i nivelit të zonës kadastrale në hierarkinë kadastrale kombëtare në të paktën një gjuhë zyrtare të Bashkimit Evropian.

-- Përshkrimi --
Psh. për Spanjën, emri i nivelit mund të jepet si "municipio" (në Spanjisht) dhe si "municipality" (në anglisht).

[Detyrueshme : PO]

Etiketa : CharacterString

-- Emri --
Etiketa

-- Përkufizimi --
Tekst i përdorur gjerësisht për të shfaqur identifikimin e zonës kadastrale.

-- Përshkrimi --
Etiketa është zakonisht pjesa e fundit e referencës së zonës kadastrale kombëtare ose vetë referencës apo emrit.

[Detyrueshme : PO]

EVlefshmeDeri : Datë-Orë
Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Emri --
E vlefshme deri.

-- Përkufizimi --
Data dhe koha në të cilën zona kadastrale përfundon/ose do të përfundojë së përdoruri ligjërisht.

-- Shënim --
Kjo është data dhe ora e referencës kadastrale kombëtare e cila nuk mund të përdoret më në veprimet ligjore.

[Detyrueshme : JO]

EVlefshmeNga : Datë-Orë
Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Emri --
E vlefshme nga.

-- Përkufizimi --
Data dhe koha zyrtare e zonës kadastrale që ishte/do të vendoset ligjërisht.

Atributet

-- Shënim --
Kjo është data dhe koha kur mund të përdoret referenca kadastrale kombëtare në veprimet ligjore.

[Detyrueshme : PO]

FillimiIJetëgjatësisë : Datë

-- Emri --
Fillimi i jetëgjatësisë

-- Përkufizimi --
Data në të cilën ky Versioni i objektit hapësinor është krijuar ose ndryshuar në të dhënat hapësinore.

[Detyrueshme : PO]

Gjeometria : Poligon

-- Emri --
Gjeometria

-- Përkufizimi --
Gjeometria e zonës kadastrale.

[Detyrueshme : PO]

InspireId : Identifikues
Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Emri --
Inspire Id

-- Përkufizimi --
Identifikues i jashtëm i objektit hapësinor.

-- Përshkrimi --
Një objekt identifikues i jashtëm është një identifikues unik i objektit të publikuar nga autoriteti përgjegjës, i cili mund të përdoret nga aplikacionet e jashtme të referimit të objektit hapësinor. Identifikuesi është një identifikues i objektit hapësinor, jo një identifikues i fenomenit në botë.

[Detyrueshme : PO]

MbarimiIJetëgjatësisë : Datë
Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Emri --
Mbarimi i jetëgjatësisë

-- Përkufizimi --
Data në të cilën ky Versioni i objektit hapësinor është përfunduar.

[Detyrueshme : JO]

Atributet
Niveli : VleraENivelitTëZonësKadastrale **-- Emri --** Niveli **-- Përkufizimi --** Niveli i zonës kadastrale në hierarkinë kadastrale kombëtare [Detyrueshme : PO]
PikaReferencë : Pikë Shumëllojshmëria: [0..1] **-- Emri --** Pika referencë **-- Përkufizimi --** Një pikë brenda zonës kadastrale. **-- Shënim--** P.sh. Centroidi i gjeometrisë së parcelës kadastrale. [Detyrueshme : PO]
ReferencaKombëtareEZonësKadastrale : CharacterString **-- Emri --** Referenca kombëtare e zonës kadastrale **-- Përkufizimi --** Identifikuesi tematik në nivel qendror, përgjithësisht kodi i plotë kombëtar i zonës kadastrale. **-- Shënim--** P.sh. 03260000AB (Francë), 30133 (Austria), APD00F (Holandë). [Detyrueshme : PO]
SaktësiaELlogaritur : Gjatësi Shumëllojshmëria: [0..1] **--- Emri --** Saktësia llogaritur **-- Përkufizimi --** Saktësia absolute e përllogaritur e pozicionimit të parcelës kadastrale në Sistemin Koordinativ referencë të përdorur nga INSPIRE. Saktësia absolute e pozicionimit është vlera mesatare e pozicionimit të pasigurive për një grup pozicionesh, ku pasigurité pozicionale janë: largësia mes një pozicioni të matur dhe asaj çfarë konsiderohet si pozicioni i vërtetë përkatës.

Atributet

-- **Përshkrimi** --
Kjo vlerë mesatare mund të vijë nga matjet cilësore në një popullsi homogjene të parcelave kadastrale ose nga një përllogaritje e bazuar në njohuritë e proceseve të prodhimit dhe saktësisë së tyre.

[Detyrueshme : PO]

LIDHJET

Lidhjet (drejtimi: Origjina -> Objektivi)

-- Përkufizim --
Reflekton hierarkinë e përcaktimit të indeksit kadastral në një vend (rendi i parë më i larti)

Origjina: (Class) ZonaKadastrale «featureType»

Objektivi: «voidable» NiveliINjësisëMëTëLartë (Class) ZonaKadastrale «featureType»
Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Përkufizimi --
Niveli tjetër më i lartë i zonës kadastrale përmban këtë zonë kadastrale.

Lidhjet (drejtimi: Origjina -> Objektivi)

-- **Përkufizim** --
Reflekton hierarkinë e përcaktimit të indeksit kadastral në një vend (rendi i parë më i larti)

Origjina: (Class) ZonaKadastrale «featureType»

Objektivi: «voidable» NiveliINjësisëMëTëLartë (Class) ZonaKadastrale «featureType»
Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Përkufizimi --
Niveli tjetër më i lartë i zonës kadastrale përmban këtë zonë kadastrale.

Lidhjet (drejtimi: Origjina -> Objektivi)

-- **Përkufizim** --
Zona kadastrale përmban këtë parcelë kadastrale.

Origjina: (Class) ParcelatKandastrale «featureType»

Objektivi: «voidable» ZonaKadastrale (Class) ZonaKadastrale «featureType»
Shumëllojshmëria: [0..1]

-- Përkufizimi --
Zona kadastrale e njësisë më të ulët përmban këtë parcelë kadastrale.

3.1.4. METADATA.

3.1.4.1. ELEMENTËT E METADATA-VE

Në tabelën e mëposhtme paraqiten këto elementë:

- Kolona e parë ofron një referencë të pjesës përkatëse në Rregulloren e Metadatës, e cila përmban një përshkrim më të hollësishëm.
- Kolona e dytë specifikon emrin e Metadatës.
- Kolona e tretë specifikon shumëllojshmërinë.
- Kolona e katërt specifikon gjendjen, sipas të cilës elementi bëhet i detyrueshëm.

Pjesa e rregullores së metadatave	**Elementi i Metadata-ve**	**Shumëllojshmëria**	**Gjendja**
1.1	Titulli i burimit	1	
1.2	Abstrakti i burimit	1	
1.3	Lloji i burimit	1	
1.4	Lokalizuesi i burimit	0..*	I detyrueshëm, nëse një URL është e disponueshme për të përftuar informacione të tjera në burim, dhe/ose shërbimeve të aksesit.
1.5	Identifikuesi unik i burimit	1..*	
1.7	Gjuha e burimit	0..*	E detyrueshme, nëse burimi përfshin informacion në tekst.
2.1	Kategoria e temës	1..*	
3	Fjalë kyçe	1..*	
4.1	Kuti e kornizës gjeografike	1..*	
5	Referenca kohore	1..*	
6.1	Cikli i jetës	1	
6.2	Rezolucioni gjeohapësinor	0..*	I detyrueshëm për grupet e të dhënave dhe serive të tyre, nëse mund të specifikohet shkalla e barasvlershme me to ose një distancë.
7	Përputhshmëria	1..*	

8.1	Kushtet për aksesin dhe përdorimin	1..*	
8.2	Kufizimet e aksesit publik	1..*	
9	Autoriteti përgjegjës	1..*	
10.1	Pika e kontaktit metadata-ve	1..*	
10.2	Data e metadata-ve	1	
10.3	Gjuha e metadata-ve	1	

3.1.4.2. ELEMENTËT E METADATA-VE PËR NDËRVEPRUESHMËRINË

Tabelat përshkruajnë elementët e metadata-ve të cilat përmbajë informacionin e mëposhtëm:

- Kolona e parë siguron një referencë për një përshkrim më të detajuar.
- Kolona e dytë specifikon emrin e elementit metadata.
- Kolona e tretë specifikon shumëllojshmërinë.
- Kolona e katërt specifikon kushtet, nën të cilat elementi i dhënë bëhet i detyrueshëm.

Në mënyrë specifike, metadatat për temën **Parcelat Kadastrale** jepen të tabeluara më poshtë:

Specifikimi i të dhënave për Temën Parcelat Kadastrale	**Elementi Metadata**		**Kushtet**
3.1.4.2.1	Referenca e Sistemit Koordinativ	1	-
3.1.4.2.2	Reference e Përkohshme e Sistemit	0...*	I detyrueshëm, nëse grupi i të dhënave hapësinore ose një nga tipet e veçorive të tij që përmban informacion të përkohshëm që nuk i referohen kalendarit gregorian apo CoordinatedUniversal Time.
3.1.4.2.3	Kodimi	1...*	-
31.4.2.4	Karakteri i Kodimit	0...*	I detyrueshëm, në qoftë se një kodim me bazë jo XML është përdorur që të mos suportojë UTF-1
3.1.4.2.5	Lloji i Përfaqësimit Hapësinor	1... *	Metoda e përdorur hapësinore paraqet informata gjeografike

3.1.4.2.1. Sistemi Koordinativ Referencë

Emri I Elementit Metadata	Sistemi Koordinativ Referencë
Përkufizimi	Përshkrimi Sistemeve Koordinativë të Referencës të përdorur në grupin e të dhënave hapësinore
Iso 19115 Numri dhe Emërtimi	13. referenceSystemInfo
ISO/TS 19139	referenceSystemInfo
INSPIREI detyrueshëm /i kushtëzuar	I detyrueshem
INSPIREShumëllojshmëria	1
Lloji i të dhënave (ISO 19115 no.)	186. MD_ReferenceSystem
Vlera e fushës	Për të identifikuar sistemin referencë duhet të sigurohet IdentifikuesiReferencëSistemit (RS_Identifikues). SHËNIM udhëzime më specifike, në veçanti në vlerat e paracaktuara për plotësimin e atributeve të IdentifikuesiReferencëSistemit duhet të bihet dakord mes shteteve anëtare gjatë fazës së zbatimit të mbështetjes së ndërveprimit.
Instruksionet e implementimit	
Shembull	referenceSystemIdentifier: code: ETRS_89 codeSpace: INSPIRE RS registry
Shembull i kodimit XML	<gmd:referenceSystemInfo> <gmd:MD_ReferenceSystem> <gmd:referenceSystemIdentifier> <gmd:RS_Identifier> <gmd:code> <gco:CharacterString>ETRS89 </gco:CharacterString> </gmd:code> <gmd:codeSpace> <gco:CharacterString>INSPIRE RS registry</gco:CharacterString> </gmd:codeSpace> </gmd:RS_Identifier> </gmd:referenceSystemIdentifier> </gmd:MD_ReferenceSystem> </gmd:referenceSystemInfo>
Komente	

3.1.4.2.2. Sistemet Koordinative Referencë, të përkohshme

Emri i Elementit Metadata	Sistemi Referencë i Përkohshëm
Përkufizimi	Përshkrimi i sistemeve të referencës të përkohshme të përdorura në setin e të dhënave
Iso 19115 Numri dhe Emërtimi	13. referenceSystemInfo
ISO/TS 19139	referenceSystëmInfo
INSPIRE I detyrueshëm /i kushtëzuar	I detyrueshëm, nëse grupi i të dhënave hapësinore ose një nga tipet e vecorive të tij që përmban informacion të përkohshëm që nuk i referohen kalendarit Gregorian.
INSPIRE Shumëllojshmëria	0..*
Lloji i të dhënave (ISO 19115 no.)	186. MD_ReferenceSystem

Vlera e fushës	Asnjë tip specifik nuk është përcaktuar në ISO 19.115 për sistemet e referimit të përkohshëm. Kështu, elementët gjenerik MD_ReferenceSystem dhe referencë SystemIdentifier (RS_Identifier) do të ofrohen.
Instruksionet e implementimit	
Shembull	referenceSystemIdentifier: code: GregorianCalendar codeSpace: INSPIRE RS registry
Shembull i kodimit XML	<gmd:referenceSystemInfo> <gmd:MD_ReferenceSystem> <gmd:referenceSystemIdentifier> <gmd:RS_Identifier> <gmd:code> <gco:CharacterString>GregorianCalendar </gco:CharacterString> </gmd:code> <gmd:codeSpace> < gco:CharacterString>INSPIRE RS Registry </gco:CharacterString> </gmd:codeSpace> </gmd:RS_Identifier> </gmd:referenceSystemIdentifier> </gmd:MD_ReferenceSystëm> </gmd:referenceSystemInfo>
Komente	

3.1.4.2.3. Kodimi

Emri i Elementit Metadata	**Kodimi**
Përkufizimi	Përshkrimi i konstruktit të gjuhës kompjuterike që specifikon përfaqësimin e objekteve të të dhënave në një rekord, fotografi, mesazh, pajisje ruajtje ose në kanalin e transmetimit
Iso 19115 Numri dhe Emertimi	271. distributionFormat
ISO/TS 19139	distributionInfo/MD_Distribution/distributionFormat
INSPIRE I detyrueshëm /i kushtëzuar	I detyrueshëm,
INSPIRE Shumëllojshmëria	1....*
Lloji i të dhënave (ISO 19115 no.)	284. MD_Format
Vlera e fushës	Vlerat e pronës (emër, version, specifikim) të specifikuara, do të përdoren për të dokumentuar përzgjedhjen dhe alternativat e kodimit.
Instruksionet e implementimit	
Shembull	Emri: <Emri i skemës së aplikuar> GML skemë aplikimi version: specifikim version 3.1rc1: D2.8.I.8 Data Specifikimet për Parcelat Kadastrale - Udhëzime teknike

Shembull i kodimit XML	<gmd:MD_Format> <gmd:name> <gco:CharacterString>SomeApplicationSchema GML application schema</gco:CharacterString> </gmd:name> <gmd:version> <gco:CharacterString>3.1rc1</gco:CharacterString> </gmd:version> <gmd:specification> <gco:CharacterString>D2.8.I.8 Data Specification on Hydrography – Technical Guidelines</gco:CharacterString> </gmd:specification> </gmd:MD_Format>
Komente	

3.1.4.2.4. Karakteret e kodimit

Emri i Elementit Metadata	**Karakteret e Kodimit**
Përkufizimi	Karakteret e kodimit përdoren në setin e të dhënave.
Iso 19115 Numri dhe Emërtimi	
ISO/TS 19139	
INSPIRE i detyrueshëm /i kushtëzuar	I detyrueshëm, në qoftë se një kodim i përdorur nuk është i bazuar në UTF-8.
INSPIRE Shumëllojshmëria	0....*
Lloji i të dhënave (ISO 19115 no.)	
Vlera e fushës	
Instruksionet e implementimit	
Shembull	-
Shembull i kodimit XML	<gmd:characterSet> <gmd:MD_CharacterSetCode codeListValue="8859part2" codeList="http://standards.iso.org/ittf/PubliclyAvailableStandards/ISO_19139_Schemas/reOrigjinas/Codelist/ML_gmxCodelists.xml#CharacterSetCode">8859-2</gmd:MD_CharacterSetCode> </gmd:characterSet>
Komente	

3.1.4.2.5. Lloji i përfaqësimit hapësinor

Emri i Elementit Metadata	**Lloji i Përfaqësimit Hapësinor**
Përkufizimi	Metodat e përdorura hapësinore paraqesin informata gjeografike
Iso 19115 Numri dhe Emërtimi	37. spatialRepresentationType

ISO/TS 19139	
INSPIRE i detyrueshëm /i kushtëzuar	I detyrueshëm
INSPIRE Shumëllojshmëria	1....*
Lloji i të dhënave (ISO 19115 no.)	B.5.26 MD_SpatialRepresentationTypeCode
Vlera e fushës	
Instruksionet e implementimit	I vlerave të përfshira në listën e koduar në ISO 19115 (vektor, rrjet, textTable, TIN, stereoModel, video), vetëm vektor, rrjet dhe TIN duhet të përdoren. SHËNIM vlerat Lista kodi shtesë mund të përcaktohen bazuar në reagimet nga zbatimi
Shembull	--
Shembull i kodimit XML	
Komente	

3.1.5. SISTEMET REFERENCË, NJESITË E MATJES DHE RRJETAT GJEOGRAFIKE.

SISTEMET STANDARDE TË REFERIMIT, NJESITË E MATJEVE DHE RRJETET

Sistemet koordinative referencë, njësitë e matjeve dhe sistemet e rrjeteve gjeografike të përfshira në këtë nën-seksion janë standardet që do të përdoren për të gjitha grupet e të dhënave INSPIRE, përveç kur ka përjashtime specifike të temës dhe/ose kërkesa të tjera të përcaktuara në seksionin 6.2.

A. KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE E SHQIPËRISË

Korniza Referuese Gjeodezike Shqiptare që do të përdoret në Republikën e Shqipërisë do të quhet:

"Korniza Referuese Gjeodezike Shqiptare 2010" ose shkurt (KRGJSH-2010 – kodi **EPSG: 6870** [1]), ku "2010" është indeksi që lidhet me "epokën" në të cilën janë përcaktuar koordinatat e pikave gjeodezike të monumentalizuara në territorin e Republikës së Shqipërisë. KRGJSH-2010 do të përcaktohet duke u mbështetur në Kornizën Referuese Gjeodezike Europiane. KRGJSH-2010 do të përdoret në të gjitha aplikacionet që lidhen me përdorimin e koordinatave në territorin e vendit. Lidhja midis KRGJSH-2010 dhe sistemeve të tjera të përdorura në vendin tonë do të bëhet duke përdorur parametrat e transformimit të llogaritura për çdo rast.

KRGJSH-2010 përfshin:

a) parametrat gjeodezikë bazë të përcaktuar në Sistemin Referues Gjeodezik 1980 (GRS-80) si më poshtë:
- Rrezja e ekuatorit të tokës: a = 6 378 137m;
- Konstantja gravitacionale gjeocentrike e tokës duke përfshirë edhe atmosferën: GM = 3 986 005 x 10^{-8} m^3s^{-2};
- Faktori dinamik i figurës së tokës pa përfshirë baticën e qëndrueshme: J2 = 108 263 x 10^{-8};
- Këtij faktori i korrespondon shtypja në pole: 1/f = 298.257222100882711;
- Shpejtësia këndore e rrotullimit të tokës: ω = 7 292115.0 x 10^{-11}rad.sek^{-1}

b) sistemin koordinativ gjeodezik ETRS 89;

c) sistemin e lartësive që realizohet nëpërmjet reperave të rrjetit shtetëror të nivelimit të përfshirë në Rrjetin Unik Europian të Nivelacionit (UELN) dhe të përcaktuara në Sistemin Referues Vertikal Europian (EVRS) me ndihmën e të dhënave për forcën e rëndesës të unifikuara në sistemin International Gravity Standardization Network 1971 (IGSN 1971).

d) sistemin e koordinatave në plan, i cili mundësohet nga dy projeksione hartografike:
- Projeksioni Tërthor Zonal i Merkatorit (TMzn) për harta në shkallë më të madhe se 1:500.000 me parametrat e meposhtme:
  - Elipsoidi referencë: GRS80
  - Meridiani fillestar: Grinuiç
  - Meridiani qendor (MQ): 20^0
  - Shkalla e shformimit në meridianin qendror (k_0): 1
  - Fallco e lindjes: 500 000 m
  - Fallco e veriut: 0 m

[1] Shiko Aneks 4.3

- Projeksioni Konik Konform i Lambertit (LCC) për harta në shkallë 1:500 000 dhe më të vogla.

B. SISTEMET KOORDINATIVE REFERENCË SIPAS INSPIRE

1.2 Datumi

Datumi për sistemet koordinative referencë dy-dimensionale dhe tre-dimensionale

Për sistemet koordinative referencë dy-dimensionale dhe tre-dimensionale dhe komponentja horizontale e sistemeve koordinative referencë të kombinuara të përdorura për të bërë të disponueshëm grupin e të dhënave hapësinore, si datum do te jetë datumi i Sistemit Tokësor Referencë Evropian 1989 (ETRS89) në zona brenda kufijve gjeografikë të tij, ose datumi i Sistemit Tokësor Referencë Ndërkombëtar (ITRS) ose sisteme koordinative referencë e gjeodezike të tjera të përputhura me ITRS, në zona që ndodhen jashtë kufijve gjeografikë të ETRS89. Të përputhura me ITRS do të thotë që përkufizimi i sistemit bazohet në përkufizimin e ITRS dhe ka një marrëdhënie të mirë-dokumentuar mes dy sistemeve, sipas EN ISO 19111.

1.3 Sistemet koordinative referencë

Sistemet koordinative referencë

Grupet e të dhënave hapësinore do të bëhen të disponueshme duke përdorur të pakten një prej sistemeve koordinatave referencë të caktuara në seksionet 1.3.1, 1.3.2 dhe 1.3.3, përveç kur qëndron njëri prej kushteve të caktuara në seksionin 1.3.4.

1.3.1 Sistemet koordinative referencë tre-dimensionale

- Koordinatat karteziane tre-dimensionale bazohen në një datum të caktuar në seksionin 1.2 dhe përdorin parametrat e elipsoidit GRS80 (Sistemi Gjeodezik Referencë 1980).
- Koordinatat gjeodezike tre-dimensionale (gjerësia, gjatësia dhe lartësia elipsoidike) bazohen në një datum të caktuar në seksionin 1.2 dhe përdorin parametrat e elipsoidit GRS80.

1.3.2 Sistemet koordinative referencë dy-dimensionale

- Koordinatat gjeodezike dy-dimensionale (gjerësia dhe gjatësia) bazohen në një datum të caktuar në seksionin 1.2 dhe përdorin parametrat e elipsoidit GRS80.
- Koordinatat në plan përdorin sistemin koordinativ referencë ETRS89 me projeksion LAEA (Lambert Azimuthal Equal Area) për analiza hapësinore dhe raportime, ku duhet të pasqyrohen sipërfaqet e vërteta.
- Koordinatat në plan përdorin sistemin koordinativ referencë ETRS89 me projeksion LCC (Lambert Conformal Conic) për hartografime konforme në territorin e Europës në shkallë të barabarta ose më të vogla se 1:500 000.
- Koordinatat në plan përdorin sistemin koordinativ referencë ETRS89 me projeksion TM (Transverse Mercator) për hartografime konforme në territorin e Europës në shkallë të barabarta ose më të mëdha se 1:500 000.

1.3.3 Sistemet koordinative referencë të kombinuara

1. Për komponenten horizontale të sistemit koordinativ referencë të kombinuar, një prej sistemeve koordinative referencë të caktuara në seksionin 1.3.2 do të përdoret.
2. Për komponenten vertikale, do të përdoret një prej sistemeve koordinative referencë të mëposhtme:
   - Për komponenten vertikale në sipërfaqen tokësore, do të përdoret Sistemi Vertikal Referencë Europian (EVRS) për të shprehur lartësitë e lidhura me gravitetin brenda kufijve gjeografikë të këtij sistemi. Në

zona të cilat ndodhen jashtë kufijve gjeografikë të EVRS, do të përdoren sisteme vertikale referencë të tjera të lidhura me fushën e gravitetit tokësor për të shprehur lartësitë e lidhura me gravitetin.
- Për komponenten vertikale në atmosferen e lirë, presioni barometrik i konvertuar në lartësi duke përdour ISO 2533:1975 Atmosferen Standarde Ndërkombëtare, ose do të përdoren sisteme referencë të tjera lineare ose parametrike. Aty ku janë përdorur sisteme referencë parametrike të tjera, ato do të përshkruhen në një referencë të kuptueshme duke përdorur EN ISO 19111-2:2012.
- Për komponenten vertikale në zonat detare ku ka një rang të ndjeshëm batice (ujëra baticor), si sipërfaqe referencë do të përdoret Batica më e ulët Astronomike (LAT).
- Për komponenten vertikale në zonat detare ku nuk ka një rang të ndjeshëm batice, në oqeanet e hapura dhe efektivisht në ujëra më të thella se 200 metra, si sipërfaqe referencë do të përdoret niveli mesatar i detit (MSL) ose një nivel referencë i mirë-përcaktuar i afërt me MSL.

1.3.3 Sistemet koordinative referencë të tjera

Si përjashtime, ku mund të përdoren sisteme referencë të tjera nga ato të listuara në 1.3.1, 1.3.2 ose 1.3.3, janë:

1. Sisteme koordinative referencë të tjera mund të caktohen për temat e të dhënave hapësinore specifike në këtë Aneks.
2. Për zonat (regjionet) që ndodhen jashtë kontinentit të Europës, Shtetet Anëtare (MS) mund të përcaktojnë sisteme koordinative referencë të përshtatshme.

Kodet gjeodezike dhe parametrat e nevojshëm për përshkrimin e këtyre sistemeve koordinative referencë dhe të cilat lejojnë veprimet e konvertimit dhe transformimit duhet të dokumentohet dhe duhet të krijohet një identifikues, sipas EN ISO 19111 dhe ISO 19127.

1.4 Paraqitja

Sistemet koordinative referencë të përdorura në shërbimin e shikimit të rrjetit

Për shfaqjen e grupeve të të dhënave hapësinore nëpërmjet shërbimit të shikimit të rrjetit siç specifikohet në rregulloren nr. 976/2009, së paku sistemet koordinative referencë për koordinatat gjeodezike dy-dimensionale (gjërësia, gjatësia) do të jenë të disponueshme.

1.5 Identifikuesit për sistemet koordinative referencë

Identifikuesit e sistemeve koordinative referencë

1. Parametrat dhe identifikuesit e sistemit koordinativ referencë do të menaxhohen në një ose disa regjistra të përbashkët për sistemet koordinative referencë.
2. Vetëm identifikuesit që përmbajnë një regjistër të përbashkët do të përdoren për referimin tek sistemet koordinative referencë të listuara në këtë seksion.
3. Identifikuesit e listuar në tabelën 2 do të përdoren për referimin tek sistemet koordinative referencë të përdorura në një grup të dhënash.

Këto udhëzuese teknike propozojnë përdorimin e http URl-të të ofruara nga Open Geospatial Consortium si identifikues të sistemit koordinativ referencë (shiko identifikuesit për CRS-të standard më poshtë). Këto janë të bazuara dhe të drejtojnë tek përkufizimi në regjistrin e parametrave gjeodezik EPSG (*http://www.epsg-registry.org/*).

Shënim: Identifikuesit e CRS mund të përdoren prsh në:

- Kodimin e të dhënave,

- Metadatat e grupeve dhe shërbimeve të të dhënave, dhe
- Kërkesat për shërbimet e rrjetit të INSPIRE.

Tabela 2. http URl-të për sistemet koordinative të referencës standarde:

Sistemi koordinativ referencë	**Shkurtimi**	**Identifikuesi http URl**
Korniza Referuese Gjeodezike Shqiptare. ETRS89/ Abania 2010	**KRGJSH_2010**	***http://www.epsg-registry.org/export.htm?gml=urn:ogc:def:crs:EPSG::6870***
Kartezian 3D në ETRS89	ETRS89-XYZ	*http://www.opengis.net/def/crs/EPSG/0/4936*
Gjeodezike 3D në ETRS89 mbi GRS80	ETRS89-GRS80h	*http:// www.opengis.net/def/crs/EPSG/0/4937*
Gjeodezike 2D në ETRS89 mbi GRS80	ETRS89-GRS80	*http:// www.opengis.net/def/crs/EPSG/0/4258*
Projeksion LAEA 2D në ETRS89 mbi GRS80	ETRS89-LAEA	*http:// www.opengis.net/def/crs/EPSG/0/3035*
Projeksion LCC 2D në ETRS89 mbi GRS80	ETRS89-LCC	*http:// www.opengis.net/def/crs/EPSG/0/3034*
Projeksion TM 2D në ETRS89 mbi GRS80, zona 34N (18°W deri 24°W)	ETRS89-TM34N	*http:// www.opengis.net/def/crs/EPSG/0/3046*
Lartësi në EVRS	EVRS	*http:// www.opengis.net/def/crs/EPSG/0/5730*
3D të kombinuara: Gjeodezike 2D në ETRS89 mbi GRS80, dhe lartësitë EVRS	ETRS89-GRS80-EVRS	*http:// www.opengis.net/def/crs/EPSG/0/7409*

C. SISTEMET REFERENCË TË PËRKOHSHME

Sistemet referencë të përkohshme

1. Sistemi referencë standard i përkohshëm i referuar tek pika 5 e pjesës B të Aneksit tek Rregullorja e Komisionit (EC) nr. 1205/2008 ([14]) do të përdoret, përveç rastit kur janë caktuar sisteme koordinative referencë të përkohshme të tjera për tema të të dhënave hapësinore specifike në Aneksin II.

Shënim 1: Pika 5 e pjesës B e Aneksit të Rregullores së Komisionit (EC) nr. 1205/2008 (IR-të e metadatave të INSPIRE) thekson që sistemi standard referencë do të jetë kalendari Gregorian, me datat e shprehura në përputhje me ISO 8601.

Shënim 2: ISO 8601 *Elementët e të dhënave dhe formatet e shkëmbimit – Shkëmbimi i informacionit – Pasqyrimi i datës dhe orës* është një standard ndërkombëtar që mbulon shkëmbimin e të dhënave të lidhura datën dhe orën. Qëllimi i këtij standardi është që të sigurojë një metodë të qartë dhe të mirë-përcaktuar për pasqyrimin e datës dhe orës, në mënyrë që të shmangen keqinterpretimet e pasqyrimeve numerike të datës dhe orës, veçanërisht kur të dhënat transmetohen ndërmjet shteteve me konventa të ndryshme për shkrimin numerik të datës dhe orës. Standardi organizon të dhënat në mënyrë që termi më i madh i përkohshëm (viti) shfaqet fillimisht në të dhëna varg dhe vazhdon deri te

termi më i vogël (sekondi). Ajo gjithashtu ofron një metodë të standardizuar për komunikimin e informacionit të bazuar në kohë ndërmjet zonave kohore duke duke i dhënë një spostim te Kohës Universale të Koordinuar (UTC).

Shembull: 1997 (viti 1997); 1997-07-16 (16 Korrik 1997); 1997-07-16T 19:20:30+01:00 (16 Korrik 1997, 19^{ore} 20^{min} 30^{sek}, zona kohore UTC+1).

D. NJËSITË E MATJEVE

Kërkesa dhe rregulla të tjera
2. Të gjitha vlerat e matjeve duhet të shprehen nëpërmjet njësive SI ose jo-SI të pranuara për përdorim me Sistemin Ndërkombëtar të Njësive, përveç kur specifikohet ndryshe për tema apo tipe specifike të të dhënave hapësinore.

3.1.6. CILËSIA E TË DHËNAVE.

Ky kapitull përfshin një përshkrim mbi cilësinë e të dhënave të elementëve dhe nën elementëve si dhe cilësinë e matjes së të dhënave, që duhen përdorur për të vlerësuar dhe dokumentuar cilësinë e të dhënave për data setet që lidhen me të dhënat hapësinore të temës **Parcelat Kadastrale**.

Kërkesë
Saktësia e materialeve hartografike, të cilat lidhen me tipologjinë e temës Parcelat Kadastrale, duhet të plotësojnë saktësinë ekzistuese të krijimit të këtyre materialeve, deri në momentin e krijimit dhe përcaktimit të saktësisë së Hartës për Kadastrën Multifunksionale. Ndërsa harta bazë për elementët e rinj që do krijohen, do të jetë produkti hartografik që do të krijohet nga projekti i Fotografimit Ajror i vitit 2015.

Cilësia e të dhënave të elementëve, nën-elementëve dhe matjeve duhet të përdoret për të:

- Specifikuar kërkesat apo rekomandimet lidhur me cilësinë e të dhënave të rezultateve të aplikueshme për data setet që lidhen me të dhënat hapësinore për temën Parcelat Kadastrale.
- Vlerësuar dhe dokumentuar cilësinë e elemenentëve të metadatave të të dhënave të dataseteve.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten të gjithë kërkesat për cilësinë e të dhënave të elementëve dhe nën elementëve që përmenden në këtë standard. Informacioni i cilësisë së të dhënave vlerësohet në nivelin e objekteve hapësinore, llojet e objekteve hapësinore, setet e të dhënave dhe seritë e seteve.

Rekomandim:
Ku është e pamundur për të shprehur vlerësimin e një elementi të cilësisë së të dhënave në mënyrë sasiore, vlerësimi i elementit duhet të shprehet me një deklaratë tekstuale si rezultat përshkrues i cilësisë së të dhënave.

3.1.6.1. ELEMENTËT E CILËSISË SË TË DHËNAVE:

Pjesa	**Elementi i cilësisë së të dhënave**	**Nën-elementi i cilësisë së të dhënave**	**Përkufizimi**	**Sfera e vlerësimit**
3.1.6.1.1	Kompletuar	Përjashtimi	Të dhënat e munguara nga grupi i të dhënave, siç përshkruhen nga sfera	Objekt hapësinor
3.1.6.1.2	Lidhja e qëndrueshm ërisë	Koncepti I qëndrueshmërisë	Respektimi i rregullave të skemës konceptuale	Lloji i objektit hapësinor; objekti hapësinor
3.1.6.1.3	Lidhja e qëndrueshm ërisë	Fusha qëndrueshmërisë	Respektimi i vlerave të territoreve të vlerës	Lloji i objektit hapësinor; objekti hapësinor
3.1.6.1.4	Saktësia pozicional e	Saktësi absolute ose e jashtme	Afrimi me vlerat e koordinatave të raportuara të pranuara si të vërteta ose të vërteta	Objekt hapësinor

3.1.6.1.1. KOPLETUAR – PËRJASHTIMI. (COMPLETENESS – OMISSION)

Rekomandim:

Përjashtimi duhet të vlerësohet dhe të dokumentohet duke përdorur normën e artikujve të tepërt të përcaktuara në tabelat e mëposhtme.

Emri	**Norma e artikujve të tepërt**
Emri alternativ	-
Cilësia e të dhënave të elementëve	Kompletuar
Cilësia e të dhënave të nën-elementëve	Përjashtimi
Cilësia e të dhënave të matjeve themelore	Shkalla e gabimit
Përkufizim	Numri i artikujve të hequr në setet e të dhënave në lidhje me numrin e artikujve që duhet të ishin të pranishëm.
Përshkrim	-
Fusha vlerësimit	Objekte hapësinore
Fusha raportimit	Objekte hapësinore
Parametër	-
Cilësia e të dhënave të llojeve të vlerave	Real, përqindje, raport
Cilësia e të dhënave të strukturës të vlerave	-
Burimi reference	ISO/DIS 19157 Geographic information – Data quality
Shembull	-
Masa identifikuese	7

3.1.6.1.2. LOGJIKA E QËNDRUESHMËRISË – KONCEPTI I QËNDRUESHMËRISË. (LOGICAL CONSISTENCY – CONCEPTUAL CONSISTENCY)

Rekomandim:

Për testet në qëndrueshmërinë konceptuale, rekomandohet për të përdorur cilësinë e të dhënave të nën elementëve të 'Logjika e qëndrueshmërisë– Koncepti i qëndrueshmërisë' dhe masat e 'Numri i artikujve jo në përputhje me rregullat e skemës konceptuale' dhe 'Numri i mbivendosjeve të pavlefshme të sipërfaqeve' të përcaktuara në tabelat e më poshtë:

Emri	**Numri i artikujve jo në përputhje me rregullat e skemës konceptuale**
Emri alternativ	-
Cilësia e të dhënave të elementëve	Logjika e qëndrueshmërisë
Cilësia e të dhënave të nën-elementëve	Koncepti i qëndrueshmërisë
Cilësia e të dhënave të matjeve themelore	Numri i gabimit
Përkufizim	Numërimin e të gjithë artikujve në setet e të dhënave të cilat nuk janë në përputhje me rregullat e skemës konceptuale.

Përshkrim	Nëse skema konceptuale në mënyrë të qartë ose të padyshimtë përshkruan rregullat, këto rregulla do të ndiqen. Shkeljet kundër rregullave të tilla mund të jenë, për shembull, vendosja e pavlefshme e tipologjive brenda një tolerancë të caktuar, dublikimi i elementëve dhe mbivendosjet të pavlefshme të tyre.
Fusha vlerësimit	Objektet hapësinore, llojet e objekteve hapësinore
Fusha raportimit	Setet e të dhënave
Parametër	-
Cilësia e të dhënave të llojeve të vlerave	Integer
Cilësia e të dhënave të strukturës të vlerave	-
Burimi reference	ISO/DIS 19157 Geographic information – Data quality
Shembull	-
Masa identifikuese	10

3.1.6.1.3. LOGJIKA E QËNDRUESHMËRISË – FUSHA E QËNDRUESHMËRISË. (LOGICAL CONSISTENCY – DOMAIN CONSISTENCY)

Rekomandim:

Për testet mbi fushën e qëndrueshmërisë, rekomandohet për të përdorur cilësinë e të dhënave të nën elementëve të 'Logjika e qëndrueshmërisë– Fusha e qëndrueshmërisë' dhe masat e 'Numri i artikujve jo në përputhje me fushën e tyre të vlerave' dhe 'Shkalla e përputhjes së vlerave për fushat' siç është specifikuar në tabelën e mëposhtme:

Emri	**Numri i artikujve jo në përputhje me fushën e tyre të vlerave**
Emri alternativ	-
Cilësia e të dhënave të elementëve	Logjika e qëndrueshmërisë
Cilësia e të dhënave të nën-elementëve	Fusha e qëndrueshmërisë
Cilësia e të dhënave të matjeve themelore	Numri i gabimit
Përkufizim	Numërimi i të gjithë artikujve në setin e të dhënave që nuk janë në përputhje me fushën e tyre të vlerave
Përshkrim	-
Fusha vlerësimit	Objektet hapësinore, llojet e objekteve hapësinore
Fusha raportimit	Setet e të dhënave
Parametër	-
Cilësia e të dhënave të llojeve të vlerave	Integer

3.1.6.1.4. SAKTËSIA E POZICIONIMIT – SAKTËSIA ABSOLUTE APO E JASHTME. (ABSOLUTE OR EXTERNAL ACCURACY)

Rekomandim:

Saktësia absolute ose e jashtme duhet të vlerësohet dhe dokumentohet duke përdorur emërtimin e matjes(nga ISO/DIS 19157) siç specifikohet në tabelat mëposhtë.

Emri	**Gabimi mesatar kuadratik njësi në planimetri**
Emri alternativ	-
Cilësia e të dhënave të elementëve	Saktësia e pozicionimit.
Cilësia e të dhënave të nën-elementëve	Saktësia e jashtme apo absolute.
Cilësia e të dhënave të matjeve themelore	Jo e aplikueshme
Përkufizim	Rrezja e rrethit nga pika e dhënë, në të cilën vlera e vertetë shmanget me probabilitet P
Përshkrim	
Fusha vlerësimit	Objekt hapësinor
Fusha raportimit	Objekt hapësinor, setet e të dhenave.
Parametër	-
Cilësia e të dhënave të llojeve të vlerave	-
Cilësia e të dhënave të strukturës të vlerave	-
Burimi reference	ISO/DIS 19157 Geographic information – Data quality
Shembull	-
Masa identifikuese	28

Pjesa	**Elementi dhe nën-elementi i cilësisë së të dhënave**	**Emri(at) i/e maties**	**Rezultati(et) objektive**	**Gjendja**
3.1.6.1.1	Kompletuar – Përjashtimi	Shkalla e artikujve që mungojnë	0%	Për parcelat dhe zonat kadastrale (nëse ka)
3.1.6.1.4	Saktësia pozicionale – Saktësia absolute e jashtme	Vlera mesatare e pasigurive pozicionale(1D, 2D)	Min. 16 cm	Në zonat urbane
3.1.6.1.4	Saktësia pozicionale – Saktësia absolute e jashtme	Vlera mesatare e pasigurive pozicionale(1D, 2D)	Min.40 cm	Në zonat rurale/bujqësore

3.1.6.1.5. REKOMANDIME NË CILËSINË E TË DHËNAVE

Saktësia e hartës kadastrale

1. Saktësia e hedhjes në hartën kadastrale të parcelave dhe ndërtesave, përcaktohet nëpërmjet llogaritjes së vlerës së:
   - Gabimit absolut në përcaktimin e pozicionit të pikës detaje (ΔL).
   - Gabimit në përcaktimin e distancës midis dy pikave detaje (∂L).

2. Me "Gabim absolut në përcaktimin e pozicionit të pikës detaje", do të kuptojmë madhësinë:

$$\Delta L = \sqrt{(X - X_0)^2 + (Y - Y_0)^2}$$

Ku:

X_0, Y_0 – janë koordinatat e pikës në hartën kadastrale;

X, Y - janë koordinatat e së njëjtës pike, të cilat janë përcaktuar nëpërmjet matjeve dhe llogaritjeve gjeodezike gjatë kontrollit të ushtruar në terren.

3. Me "Gabim në përcaktimin e distancës midis dy pikave detaje", do të kuptojmë madhësinë:

$$\partial L = L - L_0$$

Ku:

L_0 – është distanca në hartën kadastrale midis dy pikave detaje, të zgjedhura rastësisht në të njëjtin objekt ose nga objekte fqinje.

L – është distanca e matur gjatë kontrollit në terren midis të njëjtave pika të zgjedhura në hartën kadastrale.

4. Vlerat e lejuara për ΔL dhe ∂L në qendrat e banuara janë:
   a) Për pikat kufitare të parcelave dhe të planimetrisë së ndërtesave me themele, të përcaktuara me matje gjeodezike:

$$\Delta L <= 16\text{cm dhe } \partial L <= 10\text{cm}$$

5. Vlerat e lejuara për ΔL dhe ∂L jashtë qendrave të banuara janë:
   a) Për pikat kufitare të parcelave dhe planeve të ndërtesave masive me themele, të përcaktuara me matje gjeodezike:

$$\Delta L <= 40\text{cm dhe } \partial L <= 30\text{cm}$$

Ndryshimi i lejuar në përcaktimin e sipërfaqes së parcelës

Ndryshimi i lejuar në përcaktimin e sipërfaqes së parcelës që përftohet si diferencë midis sipërfaqes së parcelës në hartën kadastrale dhe sipërfaqes të së njëjtës parcelë të ripërcaktuar nga kontrolli në terren, llogaritet me formulën:

$$\Delta S = 2\,\partial L\,\sqrt{S}$$

Ku : ∂L – është gabimi në përcaktimin e distancës midis dy pikave detaje
S – është sipërfaqja e parcelës kadastrale e shprehur në m^2.

4. ANEKSE

4.1. KATALOGU I TIPOLOGJISË

Nr	**Emri I elementit Anglisht**	**Emri I elementit Shqip**	**Package**	**Stereotypes**
BASE				
3.1.3.2	CadastralBoundary	KufijtëKadastralë	CadastralParcels	«featureType»
3.1.3.3	BasicPropertyUnit	NjësiaBazëEZonës	CadastralParcels	«featureType»
3.1.3.4	CadastralZoningLevelValue	VleraENivelitTëZonësKadastrale	CadastralParcels	«codelist»
3.1.3.5	CadastralParcel	ParcelatKadastrale	CadastralParcels	«featureType»
3.1.3.6	CadastralZoning	ZonatKadastrale	CadastralParcels	«featureType»
ANEKSE				
A	GeographicalName	EmërtimetGjeografike	GeographicalName	«featureType» imported
B	Identifier	Identifikues	Generic Conceptual Model	«dataType» imported
C	AdministrativeUnits	KufijtëENjësiveAdministrative	AdministrativeUnits	«featureType» imported

4.2. TË DHËNAT E IMPORTUARA

A. Identifikues – (Identifier) - DataType

KodiIshtetit		
	Përkufizim	Një objekt identifikues i jashtëm është një identifikues unik i objektit të publikuar nga autoriteti përgjegjës, i cili mund të përdoret nga aplikacionet e jashtme të referimit të objektit hapësinor.
	Paketa	Base Type
	Referenca	INSPIRE Generic Conceptual Model, version 3.4 [DS-D2.5]
	Përshkrim	-

B. Emërtimet Gjeografike – (GeographicalName) - FeatureType

EmertimetGjeografike		
	Përkufizim	Emërtimi i saktë i vendosur një elementi në realitet.
	Paketa	Geographical Names
	Referenca	INSPIRE Data specification on Geographical Names [DS-D2.8.I.3]
	Përshkrim	-

C. Kufijtë E Njësive Administrative – (AdministrativeUnits) -FeatureType

KufijtëENjësiveAdministrative		
	Përkufizim	Njësia administrative, ku një shtet anëtar ka dhe / ose ushtron të drejtat juridiksionale, për qeverisjen lokale, rajonale dhe kombëtare.
	Paketa	AdministrativeUnits
	Referenca	INSPIRE Data specification on Administrative Units [DS-D2.8.I.4]
	Përshkrim	-

4.3. KODI EPSG PËR KRGJSH 2010



International Association of Oil and Gas Producers
EPSG geodetic parameters
data set version 8.5.4

Detailed Report on Projected Coordinate Reference Systems

Search Criteria: 6870

 # 1 *Code:* 6870 *Name:* ETRS89 / Albania 2010

Albania alternative identifier: KRGJSH-2010

Base GeogCRS: ETRS89

Geodetic Datum: European Terrestrial Reference System 1989

Ellipsoid: GRS 1980

Semi-major axis (a) = 6378137 metre

Inverse flattening (1/f) = 298.257222101

Prime Meridian: Greenwich

Datum origin: Fixed to the stable part of the Eurasian continental plate and consistent with ITRS at the epoch 1989.0.

Datum remarks: The distinction in usage between ETRF89 and ETRS89 is confused: although in principle conceptually different in practice both are used for the realisation.

CRS scope: Large and medium scale topographic mapping, cadastral and engineering survey.

CRS remarks: Planimetric component of Albanian Geodetic Reference Framework (KRGJSH) 2010.

CS axes:

Order	Axis Name	Abbr	Axis Units	Orientation
1	Northing	X	metre	north
2	Easting	Y	metre	east

CS remarks: Used in projected and engineering coordinate reference systems.

Map Projection: Albania 2010

Projection Method: Transverse Mercator

Parameter Name	Parameter Value	Unit of Measure
Latitude of natural origin	0 ° 0 ' 0 " N	
Longitude of natural origin	20 ° 0 ' 0 " E	
Scale factor at natural origin	1	unity
False easting	500000	metre
False northing	0	metre

Projection remarks: Planimetric component of Albanian Geodetic Reference Framework (KRGJSH) 2010.

CRS info. source: State Authority for Geospatial Information (ASIG). *Data source:* OGP *Revision date:* 18-Sep-14 *Change id:* 2014.008 2014.065

CRS area of use: 3212 Albania - onshore.

EPSG geodesy parameters. Version: 8.5.4 of 18 September 2014 **Projected Coordinate Reference Systems (detailed)** Printed on: 28-Oct-14 Page 1 of 1

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2016

Adresa:
Bulevardi "Gjergj Fishta"
pas ish-Ekspozitës "Shqipëria Sot"
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 364 lekë